

316/11 prot
20.7.2017

MEMORANDUM MIRËKËPTIMI

NDËRMJET

ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË *Prezenca në Shqipëri*

DHE

AUTORITETIT SHQIPTAR PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH- SIGURIMIT TË SHTETIT

PËR PROJEKTIN "DIALOGU KOMBËTAR, FAZA II"

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (këtëj e tutje "OSBE"), përmes Prezencës në Shqipëri (këtëj e tutje "Prezenca") e përfaqësuar nga Ambasadori Bernd Borchardt,

dhe

Autoriteti Shqiptar për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (këtëj e tutje "Autoriteti") i përfaqësuar nga Kryetarja, Gentiana Sula.

referuar bashkërisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala",

HYRJE

Nisur nga dispozitat e Kushtetutës së Shqipërisë dhe legjislacioni për të drejtat e njeriut, si edhe miratimi i Ligjit nr. 45/2015, datë 30.4.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

Të ndërgjegjshëm për shkeljet e të drejtave të njeriut në periudhën 1994-1991 nga regjimi komunist në Shqipëri;

Duke pasur parasysh angazhimin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të mos lejuar më shkeljen e këtyre të drejtave të njeriut, përmes respektimit rigoroz të standardeve të të drejtave të njeriut, konkretisht në lidhje me mbrojtjen e këtyre të drejtave,

Duke pasur parasysh se Prezenca ka kontribuar në këtë objektiv në kuadrin e Projektit "Dialogu Kombëtar, Faza I" dhe do të vazhdojë të kontribuojë përmes zbatimit të Projektit "Dialogu Kombëtar Faza II", si dhe

Në kuadrin e interesit të shprehur të Prezencës dhe vullnetit të saj për të asistuar Autoritetin në realizimin e mandatit të vet,

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi (këtej e tutje "Memorandumi").

Neni 1 **Qëllimi i Memorandumit**

Ky Memorandum krijon një kuadër bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit dhe Prezencës në lidhje me zbatimin e aktiviteteve specifike të Projektit "Dialogu Kombëtar Faza II" që konsiston në mbështetjen e një platforme për dialog kombëtar për shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist në Shqipëri, që detajohet më tej në Shtojcat 1 (projekt-propozimi) dhe 2 (lista e aktiviteteve të planifikuara) (këtej e tutje, "Projekti").

Neni 2 **Zbatimi i Projektit**

1. Projekti zbatohet nga Prezenca dhe nga Autoriteti.
2. Palët bashkëpunojnë ngushtë për realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadrin e këtij Memorandumi dhe të përcaktuara në Shtojcën 1.
3. Palët e kuptojnë dhe e pranojnë faktin që zbatimi i angazhimeve të këtij Memorandumi nga secila Palë i nënshtrohet disponueshmërisë së burimeve financiare dhe njerëzore si edhe rregulloreve, rregulave, udhëzimeve, politikave dhe procedurave të secilës Palë si edhe vendimeve të organeve drejtuese të tyre.
4. Bashkëpunimi i Palëve në kuadrin e këtij Memorandumi nuk është ekskluziv. Pra, Memorandumi në asnjë mënyrë nuk pengon secilën Palë të angazhohet në marrëveshje apo memorandume të ngjashme, përfshirë edhe kërkimin e financimeve për projektin të organizata të tjera ndërkombëtare apo ndërqeveritare, agjenci publike dhe organizata jofitimprurëse.
5. Por, nëse parashikohet që cilado Palë duhet të realizojë një aktivitet të ngjashëm me ato të renditura në Shtojcën 1, Pala në fjalë nuk mund ta bëjë këtë pa njoftuar dhe pa u konsultuar paraprakisht me Palën tjetër.

Neni 3 **Kuadri Financiar**

1. Projekti financohet përmes kontributeve jashtëbuxhetore; deri tani janë marrë kontribute nga Republika Federale e Gjermanisë bashkë me Qeverinë e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e

Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës (këtej e tutje "*Donatorët*").

2. Prezenca kryen prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të parashikuara në aktivitetet e përcaktuara në Shtojcën 1. Kjo i lejon Prezencës që të shfrytëzojë ekspertizën që disponon në prokurime, statusin e përjashtimit nga taksat dhe aftësinë e saj për të përfituar nga ekonomitë e shkallës falë kontratave të hapura që i përdor shpesh.
3. Të gjitha pajisjet e blera në kuadrin e Projektit do t'i dhurohen Autoritetit përmes një Akti Dhurimi të përgatitur nga OSBE-ja sipas rregullave dhe rregulloreve të OSBE-së.

Neni 4 **Përgjegjësitë e Prezencës**

Në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi, Prezenca ka këto përgjegjësi:

1. Zbaton Projektin në bashkëpunim me Autoritetin sipas afateve kohore të përcaktuara në Shtojcën 2.
2. Mbulon, me fondet e buxhetit të Projektit të dhëna prej Donatorëve, kostot operacionale, administrative dhe të tjera në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e Projektit që i alokohen Prezencës sipas Shtojcës 1. Fondet shpenzohen në mënyrën dhe në pajtim me rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të OSBE-së;
3. Merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin efikas të Projektit, përfshirë dhënien e informacionit të saktë dhe në kohë për vështirësi të mundshme që mund të hasen gjatë zbatimit të Projektit;
4. Prezenca zbaton aktivitetet e Projektit siç përcaktohen në Shtojcën 2, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e OSBE-së.
5. Monitoron zbatimin e përshtatshëm të Projektit dhe raporton te Donatorët për këtë zbatim të përshtatshëm.

Neni 5 **Përgjegjësitë e Autoritetit**

Në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi, Autoriteti ka këto përgjegjësi:

1. Bashkëpunon me Prezencën në zbatimin e Projektit sipas afateve kohore të përcaktuara në Shtojcën 2.
2. Merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin efikas të Projektit, përfshirë dhënien e informacionit të saktë dhe në kohë për vështirësi të mundshme që mund të hasen gjatë zbatimit të Projektit;

3. Autoriteti zbaton aktivitetet e Projektit siç përcaktohen në Shtojcën 2, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e OSBE-së.

Neni 6 **Komunikimi**

Çdo komunikim në lidhje me zbatimin e Projektit bëhet në adresat e mëposhtme:

Për Prezencën

Drejtuese Projekti: Claudia Vollmer
Adresa: OSCE PiA
Sheshi "Italia", Sheraton Tirana Hotel
1st Floor, 1010 Tirana, Albania
Telephone: +355 4 22 40 001
E-mail: Claudia.vollmer@osce.org

Për Autoritetin:

Kryetarja: Gentiana Sula
Adresa: Rruga Ibrahim Rugova, Garda e
Republikës
Telephone: 00355 692029020
E-mail: gentjana.sula@gmail.com

Palët informojnë njëra-tjetrën brenda 15 ditësh për propozime për ndryshime në Projekt apo për informacione ose të dhëna që mund të jenë të nevojshme për këtë Memorandum.

Neni 7 **Vizibiliteti**

1. Kontributi i secilës Palë në zbatimin e Projektit shfaqet qartë në çdo material të shtypur, komunikatë për shtyp, eveniment publik apo çdo material tjetër të përgatitur në kuadrin e Projektit, në respektim të plotë të rregulloreve, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave përkatëse.
2. Secilës Palë i ndalohet të përdorë emrin, emblemën apo vulën zyrtare të Palës tjetër apo shkurtesën e emrit të Palës tjetër, në çfarëdo formë apo mënyrë, pa marrë autorizimin paraprak me shkrim prej Palës tjetër.
3. Të gjitha të drejtat, titujt, interesat, përfshirë të gjitha të drejtat e autorit dhe patentës, në çdo material të prodhuar, të shpikur apo të hartuar prej Prezencës në zbatim të këtij Memorandumi i mbeten ekskluzivisht Prezencës. Autoriteti mund të përdorë materialet e prodhuara, të shpikuara apo të hartuara gjatë zbatimit të këtij Projekti në një mënyrë që është në pajtim me Projektin dhe siç parashikohet në të.

Neni 8 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që lind nga apo në lidhje me këtë Memorandum, përfshirë pavlefshmëri apo shkeljen e zgjidhjes së tij, zgjidhet me konsultim dhe negociata ndërmjet Palëve.

Neni 9 **Privilegjet dhe Imunitetet**

Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk nënkupton heqje dorë nga ndonjë privilegj apo imunitet që gëzon Prezenca dhe personeli i saj.

Neni 10
Ndryshimet

Çdo modifikim i këtij Memorandumi bëhet me miratimin me shkrim të të dy Palëve.

Neni 11
Zgjidhja e Memorandumit

Nëse njëra Palë gjykon se Memorandumi nuk mund të zbatohet më me efikasitet dhe në mënyrë të përshtatshme, konsultohet me Palën tjetër sa më shpejt. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje, secila Palë mund ta zgjidhë Memorandumin duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër 30 ditë përpara, pa u ngarkuar me detyrimin që të paguajë kompensim.

Neni 12
Shtojcat

Shtojcat e përcaktuara në Nenin 1 janë pjesë e pandashme e këtij Memorandumi.

Neni 13
Dispozitat përfundimtare

1. Ky Memorandum hyn në fuqi pasi nënshkruhet nga të dy Palët dhe ka afat deri më 31 dhjetor 2018, përveç se kur zgjidhet më herët me njoftim me shkrim nga njëra prej Palëve, siç parashikohet në Nenin 11 të Memorandumin.
2. Ky Memorandum hartohet në dy (2) kopje origjinale në gjuhën angleze, nga një për secilën Palë.



Për Prezencën e OSBE-së në
Shqipëri:

Data: 20-7-2017


Për Autoritetin:



Data: 20 07 2017